

DRITAN EGRO

**NGA PERANDORIA OSMANE NE SHTETIN SHQIPTAR:
DISA ASPEKTE TË TRASHËGIMISË DHE TË NDËRPRERJES
SË TRASHËGIMISË OSMANE**

1. Trashëgimia osmane dhe gjykimi politik i historisë

28 Nëntori i vitit 1912 edhe sot e kësaj dite shënon ngjarjen më kulmore në historinë moderne të shqiptarëve. Më së fundi u finalizua një lëvizje që kishte filluar qysh afro një shekull më parë, e cila si ambicie finale të saj kishte Shpalljen e Pavarësisë dhe ngritjen e shtetit kombëtar shqiptar në Ballkan; por, ndërsa ngritja e flamurit kombëtar shënoi shkëputjen dhe pavarësimin politik të shqiptarëve nga Perandoria Osmane, në të vërtetë e njëjta gjë nuk mund të thuhet për shuarjen e kontakteve me shtetin osman dhe aq më tepër për këputjen e të gjitha fijeve me atë realitet që, që nga ky moment e më pas, fillon të quhet: *trashëgimia osmane*.

Në përfundim të Luftës II Botërore në pushtet erdhi një grup social, i cili nuk kishte, por edhe nuk kërkonte të kishte, asnjë lidhje me “të shkuarën osmano-turke”, të cilën jo vetëm e perceptonte, por edhe e akuzonte si faktorin kryesor historik për prapambetjen e viseve shqiptare.¹ Që nga ky moment periudha post-osmane nga një realitet i prekshëm u shndërrua në histori, ose e thënë ndryshe, në subjekt studimi akademik.

Viti 1990 hapi një epokë të re përsa i përket frymëmarrjes në lëmin e studimit të historisë kombëtare. Është kjo liri akademike që ka sjellë në rend të ditës debate në lidhje me historinë dhe trashëgiminë osmane. Ndërsa periudha osmane ende nuk mund të thuhet se është mjaftueshmërisht e studiuar, problemi i trashëgimisë osmane pa ndroje mund të thuhet që nuk është studiuar fare. Sot gjykimet për të, më së shumti, janë të natyrës publicistike, por kurrsesi të natyrës shkencore, dhe

¹ D. Egro, *Historia dhe Ideologjia: një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare (nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në ditët e sotme)*, Maluka, Tiranë 2007, f. 29

studimi i trashëgimisë osmane në viset shqiptare, më së shumti, ngatërrohet me debatet e mirëfillta politike që kanë të bëjnë me atë se cili është dhe cili duhet të jetë kahu i zhvillimit afatgjatë të Shqipërisë.

Gjithsesi, e veçanta e perceptimit politik e për pasojë edhe historiografik të periudhës më shumë se pesë shekullore osmane të historisë së Shqipërisë përgjatë shek. XX është se viti 1912 është konsideruar si një datë, e cila realisht i dha fund periudhës osmane dhe që nga ai moment Shqipëria i shkëputi të gjitha lidhjet me të shkuarën osmane.²

Në fakt, duhet të kishte ndodhur krejt e kundërta: njohja e trashëgimisë osmane ka qenë, madje edhe sot është një domosdoshmëri për të njohur historinë shqiptare të shek. XX. Pa këtë dimension nuk mund të perceptohet drejt sidomos periudha midis dy Luftërave Botërore. Çdo përpjekje për ta shmangur atë, e për pasojë edhe për ta lënë pas dore studimin e saj, do të sjellë një njohje të cunguar dhe do të na pengojë në perceptimin e drejtë të periudhës në vijim, sidomos në aspektet ideologjike dhe shtetndërtuese.

Një gjë e tillë bëhet më se e domosdoshme për sa kohë konstatojmë që kasta dominuese e shtetarëve që ngritën shtetin e ri shqiptar deri në vitin 1945, më së shumti, ishte produkt i shkollës osmane të administrimit të shtetit. Gjuha osmane vazhdoi të ishte gjuha administrative në përdorim e shqiptarëve deri në fillimvitet '20,³ por edhe gjuha e komunikimit midis intelektualëve deri në vitet e Luftës II Botërore.⁴ Ishte krejt e natyrshme që politikanët dhe burokratët shqiptarë, të përgatitur në zyrat e administratës osmane të mos i braktisnin menjëherë praktikat burokratike osmane, mentalitetin perandorak dhe osmanishten si një mjet komod komunikimi për ta. Ndaj, njohja solide e gjithë periudhës osmane, e problematikës së saj nga shekulli në shekull, madje edhe e raporteve qendër-periferi, do të ishte më se e domosdoshme. Eqrem bej Vlora, më qartë se askush tjetër deri më sot,

² Ibid., f. 57-8

³ E. bej Vlora, *Bisedime mbi historinë bujqësore të Shqipërisë*, Arkivi i Institutit të Historisë, dosja: A-VII-5

⁴ Disa letra personale të shkruara në gjuhën osmane, të shkëmbyera midis intelektualëve të kohës, dëshmojnë se gjuha osmane ende vazhdonte të ishte mjet komunikimi: Arkivi i Institutit të Historisë, dosja: A-VII-5.

ndoshta edhe për faktin se familja prej nga ai vinte ishte produkt i periudhës osmane, shkruan:

“Është budallallëk të mohosh rëndësinë e periudhës së sundimit turk në Shqipëri, pasi populli shqiptar ashtu si deri në vitin 1912, kur turqit u tërhoqën përfundimisht nga Shqipëria, ... është produkt i kësaj kohe; sepse, as sundimi bizantin dhe as ai serbo-bullgar nuk kanë lënë gjurmë kaq të thella mbi këtë vend dhe mbi këtë popull”.⁵

Në fakt, Perandoria Osmane la pas një trashëgimi, e cila duhet perceptuar si një tërësi elementësh të mbarsur gjatë shekujve të sundimit të saj në rajonin e Ballkanit.

2. Elita shqiptare dhe trashëgimia osmane⁶

Akti i Shpalljes së Pavarësisë, më 28 nëntor 1912, aq sa shënonte daljen përfundimtare të shqiptarëve nga ombrella perandorake osmane, po aq do të paralajmëronte edhe fillimin e një realiteti të ri politik, i cili më së pari do të testonte aftësitë shtetformuese të shqiptarëve.

Elita shqiptare myslimane dhe e krishterë, duke filluar më intensivisht në dekadat e fundit të shek. XIX, zhvilloi një lëvizje nacionaliste, të ngjashme në shumë aspekte me ato të vendeve të tjera të Ballkanit,⁷ por fakti që ideologët e nacionalizmit shqiptar (Pashko Vassa⁸ dhe Sami Frashëri⁹) propozuan bashkëjetesën e detyruar me shtetin osman deri në një fund të mundshëm të tij, nuk kishte të bënte aq shumë me nostalgjinë për një të shkuar historike apo pozicionin e privilegjuar të shqiptarëve

⁵ E. bej Vlora & M. Amelie von Godin, *Ndihmesë për historinë e sundimit turk në Shqipëri – një skicë historike*, Shtëpia botuese “55”, Tiranë 2010, f. 14

⁶ Për një tablo më të detajuar mbi këtë temë, shih: D. Egro, “Pavarësia e Shqipërisë, një moment i rëndësishëm në tranzicionin e elitës shqiptare”, në përmbledhjen: *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar në shek. XX*, përgatitur nga Instituti i Historisë – Universiteti i Tiranës, Klean: Tiranë 2007, f. 145-52

⁷ M. Todorova, “The Ottoman Legacy in the Balkans”, *Imperial Legacy: the Ottoman Imprint on the Balkans and the Middle East*, ed. L.C. Brown, Columbia University Press 1996, f. 57

⁸ Wassa Effendi, *Etudes sur l’Albanie et les Albanais*, Constantinople 1879. Për versionin shqip, shih: Vassa Efendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*, përkthim nga frëngjishtja dhe komentim prej Mehdi Frashërit, Tiranë 1935

⁹ S. Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet: mendime për shpëtim të mëmëdheut nga rrezikët që e kanë rrethuarë*, Bukuresht 1899

brenda tij, por përkundrazi, me pragmatizmin shqiptar për të bërë aleatë përballë kërcënimeve të shpalosura nga fqinjët. Edhe dokumentacioni më i ri osman në lidhje me fillesat e nacionalizmit shqiptar e dëshmon fare qartë një dukuri të tillë.¹⁰ Për pasojë, edhe perceptimi i Fuqive të Mëdha për Shqipërinë, si një vend që në fund të sundimit osman rezultonte me dominancë myslimane, ishte krejt i ndryshëm nga ai për Turqinë e Re.

Turqia Republikane, nga ana e saj, luftoi shumë që juridikisht të konsiderohej si vetëm një prej shteteve të pavarura që dolën nga Perandoria Osmane; por, faktikisht në perceptimin e popullit turk, por edhe në perceptimin që popujt e shtetet e tjera kanë për Republikën e Turqisë, ajo edhe sot e kësaj dite konsiderohet si trashëgimtarja e Perandorisë Osmane.¹¹

Periudha mes dy Luftërave Botërore dëshmon qartazi për dyzimin e kastës drejtuese të Shqipërisë së Re. Sado që elita përpiquej, nga kujtesa e saj politike dhe kulturore nuk mund të fshihej e kaluara perandorake e Shqipërisë dhe e tyre personale.

Diplomati italian Pietro Cuaroni, i cili ka shërbyer në Shqipëri aty nga fundi i dekadës së dytë të shek. XX, e përshkruan kështu personalitetin dhe familjen e Shefqet Vërlacit, një nga njerëzit më të pasur dhe më të fuqishëm të Shqipërisë së asaj kohe:

“Aristokratët shqiptarë mbanin [në kokë] një fes, zakonisht të zi, me formë speciale pak si kapelet tona prej plisi, por pa strehë. Shefqet bej Vërlaci ishte i vetmi që e kishte fesin me ngjyra të ndryshme në përshtatje me kostumin. Por, megjithëkëtë, unë e shihja gjithmonë të veshur në mënyrën e dinjitarëve të lartë të Turqisë së dikurshme.¹²

Duke qenë se [gjatë vizitës] në Elbasan më shoqëronte bashkëshortja ime, [për të] na prituri dolën së toku bashkëshortja e Vërlacit dhe vajza e madhe, ish e fejuara e Ahmet Zogut. Për respekt ndaj personit tim më lejuan të rrija në prezencë të tyre, por shihej mirë që ato ishin mësuar [të rrinin] në harem”.¹³

¹⁰ D. Egro, “Disa të dhëna të reja mbi fillimet e nacionalizmit shqiptar”, *Studime historike*, Tiranë, nr. 3-4 2010, f. 5-18

¹¹ M. Todorova, “The Ottoman Legacy in the Balkans”, f. 69-73

¹² P. Cuaroni, *Valixhja diplomatike*, Albinform, Tiranë 1993, f. 128

¹³ *Ibid.*, f. 135: Megjithatë, më tej diplomati i lartë italian e vlerëson Vërlacin si një person me integritet, aq sa në këtë aspekt ai e krahason me profilin e konservatorit të vjetër të Italisë humbertiane.

Nga ana tjetër, ambasadori turk në Tiranë (1934-1935), Yakup Kadri Karaosmanoğlu, e përshkruan kështu Shefqet bej Vërlacin dhe familjen e tij, gjatë një vizite që edhe ai kishte kryer në Elbasan:

“... ish-deputeti i Elbasanit në parlamentin osman Shefqet beu, ishte një nga personat më të pasur të Shqipërisë. Megjithëse në Romë kishte një sërë pronash, llogari rrjedhëse dhe ndonëse një pjesë të mirë të jetës e kalonte në Romë, për konservatorizëm femrat [e familjes së tij] i kishte mbyllur brenda katër mureve të shtëpisë. Në fëmijërinë time, të tillë kryetarë familjesh kishte shumë në Manisë [të Anadollit]”.¹⁴

Duke vijuar më tej rrëfimin për qëndrimin e tij diplomatik në Tiranë, ambasadori turk shkruan se gjatë qëndrimit në Tiranë atij nuk iu puq ylli fare me pjesën kozmopolite të elitës vendase.¹⁵ Dashuria e madhe për Italinë - vazhdon ai - kishte kapluar të gjithë, madje shkonte deri atje sa përfaqësuesit e elitës shqiptare të kohës harronin madje edhe prejardhjen dhe identitetin e tyre. Rastin më tipik e përbënin përfaqësuesit e familjeve të mëdha: Libohova, Vrioni, Vërlaci dhe Alizoti. Madje, Ali Fejzi bej Alizoti ishte munduar t'i mbushte mendjen ambasadorit turk se prejardhja e familjes së tij ishte nga familja Alioti, një nga të vjetrat familje italiane. Por - përfundon ambasadori turk - Ali beu harroi të vinte në dukje faktin se një nga vëllezërit e tij në ato momente që ai fliste, ishte anëtar i Gjykatës së Lartë të Republikës së Turqisë.

Dyzimi i elitës shqiptare midis eksperiencës osmane dhe perspektivës europiane ishte ndoshta fenomeni më tipik që karakterizonte krerët shqiptarë, qofshin këta myslimanë apo të krishterë. Mehdi Frashëri e përshkruan kështu profilin e kapidanit katolik të Mirditës, Preng Bibdodës:

“... [ishte] i çuditshëm, i zgjuar dhe mjaft i kulturuar. Fliste mirë frëngjisht, italisht dhe turqisht. Kishte kaluar shumë kohë në Kastamonu të Azisë së Vogël me një rrogë të madhe, ndaj dhe ishte një turkofil i madh. Gjithë shërbëtorët i kishte turq, mbante qylaf të kuq në kokë dhe një kapotë gjenerali të Turqisë”. Kur e pyeta pse i mbante këto ai m'u përgjigj: “Mos u bëj budalla, po të mos i kem këto dhe po të mos kem titullin *pasha*, kurrkush nuk ma vë veshin në Mirditë”.¹⁶

¹⁴ Y. K. Karaosmanoğlu, *Zoraki Diplomat*, 3. baski, İletişim Yayınları, İstanbul 1984, f. 111

¹⁵ Ibid. f. 109

¹⁶ M. Frashëri, *Kujtime (1913-1933)*, OMSCA-1, Tiranë 2006, f. 62

Kurse diplomati i lartpërmendur italian, P. Cuaroni, e përshkruan kështu Iljaz bej Vrionin, një nga shtetarët e rëndësishëm shqiptarë të kohës së Mbretërisë Shqiptare:

“I edukuar në Stamboll, ai kishte qenë për shumë kohë ministër i Shqipërisë në Paris: gjithë sjellja e tij ishte një përzjerje e çuditshme e simpatike e edukatës së vjetër osmane e kohës së sultanatit dhe e manierave të njeriut të bulevardit”.¹⁷

Tranzicioni historik 1912-1944 Shqipërinë e gjeti me një shoqëri të stratifikuar qartë në aspektin social dhe atë ekonomik. Përdorimi i gjerë i titullaturës osmane *bej*, *aga*, *hanëm* dhe *efendi* ishin një dëshmi e qartë e këtij realiteti të gjithëpranuar nga shoqëria shqiptare. Këto terma që identifikojnë *sojliun* / *të fismin* nga masa e gjerë nuk tregojnë veçse një status të caktuar social dhe ekonomik, i cili rrënjët i kishte në periudhën osmane, por që i tillë vazhdoi të ishte edhe gjatë periudhës së Zogut.

Është fakt se, qysh nga mesi i viteve ‘30 shfaqen edhe thirrjet e para të qarqeve ideologjike të majta për t’u shkëputur nga mentaliteti dhe trashëgimia osmane. Thirrjet në fjalë, tërthorazi, ishin thirrje për ndryshimin e kastës politike që faktikisht kishte në duart e saj drejtimin e vendit, qysh prej nëntorit të 1912-ës. Ndërsa¹⁸, pas vitit 1944, përdorimi në publik i titullaturës së trashëguar osmane u bë simbol i luftës ndaj asaj kaste që duhej goditur politikisht dhe ekonomikisht, ndërsa jopublikisht përdorimi i saj u zbeh dukshëm për t’u ndërprerë fare me largimin nga jeta të përfaqësuesve të kësaj shtrese aty nga vitet ‘70. Një akt i tillë, veç të tjerash, shënoi një thyerje të ecurisë normale të elitës së shoqërisë shqiptare, por dhe një shkëputje që shkaktoi vonesë në konsolidimin e traditës shtetformuese shqiptare, pasi eliminimi apo largimi në emigracion i ideologëve dhe i shtetarëve që ngritën institucionet e shtetit shqiptar, të atyre që regjimi komunist me ironi i quajti *etërit e kombit*, realisht ishin personalitetet politike dhe kulturore që ngritën dhe ushqyen me mendim dhe veprim shtetin e ri shqiptar.

3. Procesi i shtetformimit dhe trashëgimia osmane

Me Shpalljen e Pavarësisë, roli i elitës vendase ishte i një rëndësie përcaktuese. Ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, Shqipëria trashëgoi

¹⁷ P. Cuaroni, *Valixhja diplomatike*, f. 139

¹⁸ S. Shpuza, “Përse nuk duhen gjatë sundimitarët e vjetër”, *Bota e Re*, viti I, nr. 6 (1 korrik 1936), Korçë, f. 3-4

një elitë politike, e cila gëzonte një bazë të fuqishme ekonomike, falë pronësisë së gjerë mbi tokën që ajo gëzonte qysh nga periudha osmane. Së dyti, ishte kjo elitë, e cila gjatë shekujve të gjatë osmanë jo vetëm ishte islamizuar, por edhe ishte integruar më shumë se elita e cilitdo popull tjetër ballkanik në Perandorinë Osmane. Ky realitet shqiptar në Ballkanin post-osman ilustron më së miri atë aspekt themelor të trashëgimisë osmane, të cilën Maria Todorova me të drejtë e quan *ndryshueshmëri rajonale*.¹⁹

Por, në një aspekt të gjitha shtetet e reja ballkanike bashkoheshin: periudhën osmane e perceptuan politikisht si *regjimi i prapambetur i së shkuarës*; dhe përtej kësaj, në luftën për ngritjen e shteteve me frymë të fortë nacionale, periudha osmane u perceptua edhe si koha e një sundimi të huaj, si *zgjedha e gjatë osmane*, që brenda kishte edhe dimensionin e saj islam,²⁰ perceptim ky që mbetet në fuqi edhe sot.²¹

Ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, është fakt historik që, pas vitit 1912, Shqipëria nuk përjetoi thyerje të elitës së saj qeverisëse; krejt natyrshëm, ish-qeveritarët osmanë me origjinë shqiptare zunë vend në drejtimin e institucioneve të reja shtetërore. Kalimi i natyrshëm dhe pa eksese i elitës shqiptare nga administrata shtetërore osmane në atë shqiptare, mishëron një nga aspektet më të dukshme dhe më të qarta të vazhdimësisë historike të trashëgimisë osmane. Rast tipik është ai i familjes Vlora: prej disa brezash dhe në mënyrë integrale Vlorajt shërbyen në poste të larta të shtetit osman; madje, Ferid Pasha, xhaxhai i Eqrem bej Vlorës, nga viti 1903-1908 shërbeu si kryeministër i Perandorisë Osmane.

Kujtimet që u botuan pas viteve '90²² dhe dokumentat që sot i gjejmë në arkivat osmane²³ dëshmojnë se edhe themeluesi dhe kryeministri i parë i shtetit të pavarur shqiptar, Ismail Qemali, ishte një ofiqar i lartë osman, i cili deri në prag të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë ka shërbyer në ofiqe të larta të shtetit osman.

¹⁹ M. Todorova, "The Ottoman Legacy in the Balkans", f. 54

²⁰ Ibid., f. 48

²¹ D. Egro, *Historia dhe Ideologjia*, f. 88-131

²² I. Qemali, *Kujtime*, Toena: Tiranë 2009

²³ *Osmanlı Arşiv Belgelerinde Arnavutluk*, T. C. Başbakanlık Devlet Arşivleri Genel Müdürlüğü, İstanbul 2008, f. 42-5.

Pas vitit 1912, ishte Eqrem bej Vlora, i cili do të kishte poste të rëndësishme administrative në institucione shtetërore dhe kulturore të shtetit të ri shqiptar.²⁴

Përvoja osmane në administrimin e shtetit, në shikim të parë, do të duhej të vlerësohej si një avantazh që Shqipëria duhej të kishte krahasuar me vendet e saj fqinje; por në vërtetë nuk ishte plotësisht kështu, pasi ish-drejtnesit shqiptarë të një perandorie ishin njëkohësisht edhe bartësit e një tranzicioni të gjatë që për kohën nuk demonstroi modelin më të mirë dhe efikas të administrimit të shtetit. Një rast i mirë ilustrimi këtu do të ishte Turhan Pashë Përmeti, ofiqar i lartë i shtetit osman, i cili në fund të karrierës u vu në krye të qeverisë shqiptare.²⁵

Kurse, shambërleri i familjes mbretërore të Zogollëve, Abdurrahman Krosi, përshkruhet kështu nga diplomati italian P. Cuaroni:

“... është fakt që [Abdurrahman Krosin] e urrenin, sidomos të rinjtë, në veçanti ata që ishin edukuar në Evropë dhe që ëndërronin si patriotë të mirë për një Shqipëri të organizuar pak më mirë, më të ndryshme. Të ndërgjegjshëm për këtë trafik influencash politike dhe ekonomike, ata e konsideronin atë, duke vlerësuar profilin e tij, si një lloj Rasputini të Shqipërisë”.²⁶

Edhe fjalët me të cilat ambasadori turk në Tiranë e përshkruan Abdurrahman Krosin shkojnë në të njëjtën linjë:

“... në Tiranë kishte një person, deputet shqiptar me emrin Apdurrahman Krosi (i njohur me llagapin Apdurrahman *Qerosi*), i cili kohë më parë kishte qenë kujdestar i Zogut. Shumë shpejt më erdhi në vesh se ai ende gëzonte një ndikim të madh mbi mbretin dhe qysh në ditët e para të mbërritjes time në Tiranë iu futa punës për të vendosur marrëdhënie miqësore me të. Gjeta një sebep dhe e ftova në ambasadë. Apdurrahman Krosi nuk dinte as të shkruante dhe as të lexonte. Ndonëse kishte jetuar për një kohë të gjatë në Stamboll përgjatë kohës që Ahmet Zogu ishte nxënës atje, turqishtja e tij ishte shumë e mangët. Por, Zoti i kishte falur një zgjuarsiri dhe inteligjencë natyrale të tillë që,

²⁴ E. bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit: Tiranë 2003, f. 307-493

²⁵ K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar, 1912-2005*, Shtëpia Botuese 55: Tiranë 2006, f. 44, 54, 87-88

²⁶ P. Cuaroni, *Valixhja diplomatike*, f. 118

unë ende pa hapur gojën ai e kishte kuptuar me kohë se çfarë do të dilte nga kjo bisedë e zhvilluar kokë më kokë”.²⁷

Kur në vitin 1927 u krijua një komision ekspertësh, i cili do të përgatiste kodin civil të Shqipërisë, Mehdi Frashëri kujton se juristët që kishin qenë nëpunës ose avokatë në Turqi dëshironin të adaptohej kodi civil zviceran për shkak se atë e kishte pranuar Turqia Republikane dhe i kishte të përkthyer në turqisht komentet përkatëse. Këtë mendim e justifikonin duke thënë se, përveç turqishtes, nuk dinin ndonjë gjuhë tjetër për të studiuar kodin e ri dhe komentet e tij.²⁸ Me hyrjen në fuqi të kodit civil në vitin 1928, populli shqiptar largohej nga jeta orientale; kurse, me pranimin e monogamisë dhe me disiplinimin e shkurorëzimit ndahej përjetë nga dispozitat e së Drejtës Islame (Sheriati).²⁹

Duke pasur parasysh këtë realitet juridik, juristi Kristo Floqi, përgatiti një libër të titulluar: *E drejta themelore konstitucionale*, të cilin e publikoi në Shkodër, në vitin 1920. Qysh në kapak të librit, ai vendosi në kllapa përkatësen turqisht të titullit: *Hukuki esasiyye*. Kurse fjalësin terminologjik të përdorur në tekst ai e paraqiti së pari në frëngjisht, së dyti në turqisht, por edhe në greqisht, pasi vetë autori ishte diplomuar për drejtësi në Athinë.

Ndryshe ndodhi në vendet e tjera të Ballkanit me shumicë të krishterë, përfaqësuesit e të cilave në strukturat shtetërore osmane ishin përfaqësuar vetëm në nivele të ulëta të administratës. Në këto vende në mënyrë të shpejtë dhe radikale u adaptuan jo vetëm modelet perëndimore të ndërtimit të institucioneve shtetërore, por u importua edhe modeli i ri i shtetarit.³⁰

Shqipëria e viteve '30 ishte një mbretëri e re e krijuar mu në mes të Evropës, por sistemi i saj politik në politikën e brendshme bazohej në parimin e *dorës së fortë*, ndërsa në politikën e jashtme ishte tërësisht e varur nga fuqitë e huaja. Një realitet të tillë ambasadori turk në Tiranë, Yakup Kadri Karaosmanoğlu, e vlerëson si një model të trashëguar nga

²⁷ Y. K. Karaosmanoğlu, *Zoraki Diplomat*, s. 107

²⁸ M. Frashëri, *Kujtime (1913-1933)*, f. 219-20

²⁹ Ibid., f. 222-3

³⁰ T. Stoianovich, “The Pattern of Serbian Intellectual Evolution, 1830-1880”, *Comparative Studies in Society and History*, vol. I, issue 3 (march, 1959), f. 242-272; M. Todorova, *Bones of Contention: the living archive of Vasil Levski and the making of Bulgaria's national hero*, Central European University Press, Budapest – New York 2009, f. 222-3

periudha e fundit e shtetit osman.³¹ Në këtë kontekst, ai nuk ngurron ta ravijëzojë kreun e shtetit shqiptar si një sundimtar të tipit lindor, pasi thekson se ai erdhi në fuqi me rrugë të dhunshme dhe për të vendosur rendin dhe mbajtur kontrollin mbi shtetin e tij krijoi një sistem policor të tipit të sulltan Abdylhamitit II (1876-1908). Sipas ambasadorit turk, Mbreti Shqiptar gjithsesi kishte meritën se vendosi rend, i dha fund anarkisë dhe i hapi rrugë krijimit të një qeverisjeje të tipit perëndimor; madje këtë e vendosi mbi baza ligjore dhe legjislative. Dhe unë - rrëfen ambasadori turk - e vendosa në sirtar revolverin që kisha sjellë me vete nga Turqia, pasi nuk ndihej më nevoja për ta mbajtur me vete atë.³²

4. Kontaktet intelektuale Shqipëri-Turqi

Në fillim të viteve '20 në gërmadhat e Perandorisë Osmane lindi Republika e Turqisë, e projektuar dhe e vënë në jetë sipas modelit shtetëror europian. Burrat e shtetit të ri turk, që po ashtu vinin nga shkolla osmane e administratës, bënë shumë kujdes me të shkuarën që mbanin mbi supe. Ndaj, në vitet '20, Parlamenti i Republikës së Turqisë ndërmori një sërë reformash të thella që synonin nga brenda realizimin e një shteti demokratik, shekullar dhe modern, por po aq edhe krijimin e imazhit të një shteti me popullsi dërrmuese myslimane, por me kah zhvillimi europian. Në këtë kontekst, Mustafa Kemal Atatürk dhe pasuesit e tij reformatorë, modernizimin e shtetit dhe integrimin e Turqisë së Re në familjen europiane e konsideruan kusht strategjik për të ardhmen e saj. Për pasojë, edhe shteti i ri turk periudhën osmane e perceptoi si “regjimi i vjetër” (*ancien regime*).³³

Këto zhvillime ndiqeshin me shumë kujdes edhe në Shqipëri; dhe kjo jo vetëm për hir të kontakteve historike. Këtë realitet ambasadori turk në Tiranë e shpreh kështu:

“shpeshherë më vinin pjesëtarë të elitës vendase dhe më thoshin: sa punë të mëdha keni bërë brenda një kohe të shkurtër, sa përpara keni ecur; ah, sikur të ishim fqinjë apo të mos ishim shkëputur prej jush”.³⁴

³¹ Y. K. Karaosmanoğlu, *Zoraki Diplomat*, f. 88-9

³² Ibid., f. 89; E. bej Vlora, *Kujtime (1885-1925)*, f. 13

³³ M. Todorova, “The Ottoman Legacy in the Balkans”, f. 48

³⁴ Y. K. Karaosmanoğlu, *Zoraki Diplomat*, f. 88

Ndërkaq, ambasadori turk nuk e fsheh kënaqësinë e tij kur bën fjalë për turqishten e pastër të Stambollit që fliste mbreti Zog dhe aq më tepër për faktin që Mbreti Shqiptar ishte një lexues i rregullt i shkrimeve të tij,³⁵ pra e thënë ndryshe, edhe Mbreti Zog ishte ndër ata shtetarë shqiptarë që ndiqte me interesim zhvillimet e brendshme dhe debatet intelektuale që zhvilloheshin në Turqinë e Re, përgjatë viteve '30.

Yakup Kadri Karaosmanoğlu, në ato vite një prej penave më të forta intelektuale në Turqi, në momentin që zbriti në portin e Durrësit, si ambasador i Republikës së Turqisë në Shqipëri, kujton me nostalgji se, përveçse nga personeli i ambasadës turke, ai u prit edhe nga njëri prej përfaqësuesve të Neoshqiptarizmit, Nebil Çika, i cili në Stamboll ku kishte studiuar, ishte bërë i njohur me emrin Ahmet Nebil, si poet i disa vargjeve të lira.³⁶

Në përfundim duhet theksuar se, shkëputja nga trashëgimia osmane, përtej nostalgjisë, për elitën shqiptare ishte e vështirë të realizohej; kurse afrimi me Perëndimin, që shihej si rrugëtim drejt përparimit, ishte një proces i vështirë që do të kërkonte kohë, por që në fakt do të ndërpritej sërish në vitin 1944. Trashëgimia osmane, për shkak të sundimit të gjatë osman u demonstrua në të gjitha fushat e jetës. Këtu ne u ndalëm vetëm në disa aspekte të vazhdimësisë dhe të ndërprerjes, por kjo trashëgimi e demonstruar fort gjatë shek. XX duhet perceptuar si një shumësi e atyre fenomeneve që origjinën e kanë në periudhën osmane dhe që kanë ngulur rrënjë thellë në arealin shqiptar.

S u m m a r y

On 28th November 1912 the Albanians raised their national flag in Vlorë and this event marked their political separation from the Ottoman Empire; however, as a matter of fact, the political independence of the Albanians did not mark the ultimate separation from the Ottoman state, and even less did this independence mark the cut of the ties with the Ottoman reality, which from 1913 onwards would be called: the Ottoman legacy.

³⁵ Ibid.

³⁶ Ibid., f. 83

However, the separation from the Ottoman legacy, apart from nostalgia, was a difficult thing to achieve by the Albanian elite. In addition, getting closer to West, which was considered the road that leads to progress, was an even more difficult process that needed time, and anyway would be interrupted again in 1944.